



# AGJENCIA PËRKRAHJE FINANCIARE NË BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL

Në bazë të nenit 7, alinea 9 e Ligjit për themelim të Agjencisë për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta Zyrtare" e Republikës së Maqedonisë numër 72/07 dhe 5/09), Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural në vijim publikon

## THIRRJE PUBLIKE nr. 07/2014

Për dorëzimin e kërkesave për shfrytëzim të mjeteve nga Programi për përkrahje financiare të zhvillimit rural për vitin 2014

### I. LËNDA E SHPALLJES

Lëndë e kësaj shpallje është ndarje e përkrahjes financiare për masën në vijim:

Kodi i masës	Emri i masës	Vlera maksimale e përkrahjes financiare
121	Investime për rritje të vlerës ekonomike të pyjeve	
1	Ekonomizim i qëndrueshëm me pyjet	- deri në 20.000 denarë për shënim të dukshëm dhe të përhershëm - deri në 500 denarë për metër kub, por jo më shumë se 10.000 denarë për shërbimet për ekonomizim të qëndrueshëm me pyjet - deri në 120.000 denarë për furnizim të pajisjeve

### II. SHFRYTËZUESIT

Të drejtë për shfrytëzim të mjeteve kanë subjektet në vijim:

Subjektet	Kodi i masës
Shfrytëzues potencial mund të jetë subjekti juridik ose fizik pronar i pyllit privat ose shoqatë e pronarëve privat të pyjeve.	Masa 122

### III. SHUMA E PËRKRAHJES FINANCIARE

Për Masën 122, përkrahja financiare paguhet sipas parimit të bashkëfinancimit të investimeve të përfunduara dhe të paguara nga ana e shfrytëzuesit në shumë prej 50% të vlerës të shpenzimeve të pranueshme të lejuara për investime.

### IV. KUSHTET PËR SHFRYTËZIMIN E MJETEVE DHE DOKUMENTACIONI I CILI DUHET TË DORËZOHET

Kërkesat për masë të veçantë dorëzohen në kopje origjinale.

Një kërkesë mund të dorëzohet një kërkesë vetëm për një masë. Një kërkesë mund të shtrojë më së shumti 2 kërkesa veç e veç për masa të ndryshme duke marrë parasysh edhe masat e tjera nga programi për zhvillim rural për vitin 2014.

Kushtet të cilat duhet ti plotësojnë kërkesuesit e mjeteve janë të përcaktuara me:

- Programin për përkrahje financiare të zhvillimit rural për vitin 2014 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 10/2014, 23/2014, 137/2014, dhe 143/2014),
- Ligjin për bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 49/2010, 53/2011, 126/2012, 15/2013, 69/2013 dhe 106/2013),
- Rregulloren për kushtet më të përafërta plotësuese për mbështetje të masave për zhvillim rural, shpenzime të pranueshme dhe shkalla e përkrahjes për shpenzimet e pranueshme për shfrytëzues për masë të veçantë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 124/2011, 80/2013 dhe 72/2014),
- Rregulloren për kriteret më të përafërta për zgjedhje të shfrytëzuesve për masë për zhvillim rural ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 124/2011 dhe 80/2013).

Kërkesuesit duhet që të shtrojnë Kërkesë përkatëse për shfrytëzimin e mjeteve për Masën 122 dhe dokumentacionin e nevojshëm të theksuar.

Kërkesuesit të cilët i kanë përmbushur kushtet për shfrytëzimin e mjeteve për masat 122 radhiten sipas datës dhe kohës së shtrimit të kërkesës.

Kërkesuesit nuk guxojnë të fillojnë me realizimin e investimit para nënshkrimit të Marrëveshjes për bashkëfinancim me Agjencinë.

Shfrytëzuesit e mjeteve duhet ti kenë të paguara të gjitha obligimet financiare ndaj Ministrisë së bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave si dhe obligimet financiare për

vitin 2013 ndaj Ndërmarrjes publike për ekonomizim me kullosat dhe kompensimin ujqor ndaj ndërmarrjeve për ekonomizim me ujërë.

### V. MARRJA E FORMULAREVE DHE UDHËZIMEVE

Fomularët "Kërkesë për shfrytëzim të mjeteve" me listën e dokumenteve të nevojshme dhe Udhëzimin për shfrytëzuesit mund të merret në ueb faqen e Agjencisë [www.ipardpa.gov.mk](http://www.ipardpa.gov.mk) si dhe në qendrat më të afërta rajonale ose njësitë punuese të Agjencisë për nxitje të zhvillimit në bujqësi çdo ditë pune prej ora 8:30 deri në ora 16:30.

Fomularët e lartpërmendur mund të merren edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në Agjenci çdo ditë pune prej ora 8:30 deri në ora 16:30 në adresë:

**Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural,  
Bul. "3-ta Makedonska Brigada" nr. 20  
(ndërtesa e Makedonija Tabak blloku C)  
1000 Shkup**

### VI. MËNYRA E DORËZIMIT TË DOKUMENTEVE

Kërkesat e plotësuara për shfrytëzim të mjeteve dhe kërkesat për pagesë nga Programi për përkrahje financiare për zhvillim rural për vitin 2014 së bashku me dokumentacionin e tërësishëm të nevojshëm dorëzohen në gjuhën maqedonase në zarf të mbyllur me shënim në këndin e majtë lart të anës së përparme të zarfit "MOS HAP" për Thirrjen publike nr. 07/2014 dhe shënimin e shifrës së masës për të cilën dorëzohet kërkesa. Kërkesa mund të dorëzohet përmes postës ose personalisht në arkivin e Agjencisë, në të kundërtën Agjencia nuk merr përgjegjësi për arrijten jo në kohë ose të pakompletuar apo hapjen e parakohshme të kërkesës.

**Afati i fundit për dorëzimin e kërkesave është 31.12.2014.**

**Kërkesat e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk do të merren parasysh.**

Informata më të detajuara në kontakt tel. (02) 3097-460 ose në kontakt e-mail adresën: [ipardpa.info@ipardpa.gov.mk](mailto:ipardpa.info@ipardpa.gov.mk) dhe ueb faqen: [www.ipardpa.gov.mk](http://www.ipardpa.gov.mk).

Kontakt:

Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural, Sektori për lejim të projekteve. Dhe Sektori për lejim të pagesave.

Telefon **02 3097 - 460**, çdo ditë pune prej ora 08.30 deri në ora 16.30

e-mail: [ipardpa.info@ipardpa.gov.mk](mailto:ipardpa.info@ipardpa.gov.mk)



AGJENCIA PËRKRAHJE FINANCIARE NË BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL